

VENDIM
Nr. 27, datë 18.5.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.5.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 27 (B) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Banu Kadzadej

SUBJEKT I INTERESUAR:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 880, datë 23.4.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja "P", 134, pika 1, shkronja "I" dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese së Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësës, që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 22.11.1992, me urdhër të kryetarit të këshillit të rrethit Elbasan kërkuësja është emëruar në detyrën e "specialistes" së privatizimit dhe në zbatim të urdhrit të datës 30.7.1997 ka vijuar marrëdhënien e punës në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, në detyrën e "specialistes" në degën e shoqërive publike Elbasan.

2. Me shkresën nr. 786 prot., datë 31.10.2013, kërkuësja është njoftuar për fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të saj të punës me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik,

Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS), për shkak të shkurtimit të vendit të punës, si rrjedhojë e ristrukturimit të institucionit, sipas urdhrit nr. 181, datë 18.10.2013 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”. Në vijim, me urdhrin nr. 85, datë 15.11.2013 të ministrit është vendosur lirimi i saj nga detyra.

3. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesëpadi me objekt: *“1. Kthim në vendin e mëparshëm të punës në pozicionin e specialistes në Degën e Shoqërive Publike Elbasan, si pasojë e pavlefshmërisë absolute të urdhrit nr. 85, datë 15.11.2013, “Për lirim nga detyra” të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. 2. Pagimin e pagës për të gjithë kohën e qëndrimit pa punë padrejtësisht deri në ekzekutimin e vendimit të gjykatës. 3. Pezullimi i zbatimit të këtij urdhri deri në përfundim të procedurave të rekrutimit në Degën e Shoqërive Publike Elbasan deri në përfundim të procesit gjyqësor”*, për të cilën gjykata, me vendimin nr. 601, datë 12.5.2014, të dhënë në prani të përfaqësuesit të kërkuësës dhe përfaqësuesit të MZHETS-së (*shih procesverbalin nr. 651, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës*), ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, rikthimin e kërkuësës në pozicionin e saj të punës, detyrimin e MZHETS-së t’i paguajë pagën dhe përfitimet e tjera nga momenti i shkëputjes së marrëdhënieve financiare deri në momentin e rikthimit në detyrë, si dhe rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të objektit të saj.

4. MZHETS-ja, përmes aktit nr. 2624/3 prot., datë 26.5.2014, ka ushtruar ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ky ankim është dërguar me postë jo në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, por asaj Tiranë. Ky akt procedural ka mbetur pa veprim deri kur kancelarja e kësaj të fundit e ka përcjellë atë me postë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. 10720 prot., datë 4.9.2014, duke informuar se ankimi është depozituar në këtë gjykatë në datën 28.5.2014.

5. Në kushtet kur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës nuk ka rezultuar i depozituar ankim brenda afatit ligjor 15-ditor nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit, kërkesja është pajisur me kopje të tij me shënimin se ai ka marrë formë të prerë në datën 27.5.2014. Në vijim ajo i është drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor privat për vënien e tij në ekzekutim. Ky i fundit ka njoftuar MZHETS-në në datën 12.8.2014 për ekzekutimin vullnetar dhe me kalimin e afatit, në kushtet e mospërmbushjes së detyrimit, ka vendosur fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, duke urdhëruar Degën e Thesarit Durrës për vendosjen e sekuestros në llogarinë e MZHETS-së.

6. Me marrjen dijeni për masën e sekuestros, MZHETS-ja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me kërkesëpadi kundër kërkuësës dhe shoqërisë përmbarimore private, me objekt: *“Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nr. 601, datë 12.5.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës. Anulimin e urdhrit për vënien e sekuestros nr. 1296 prot., datë 26.8.2014 të përmbaruesit gjyqësor E.S., si veprim absolutisht i pavlefshëm”*, duke pretenduar, ndër të tjera, se vendimi gjyqësor në fjalë nuk ishte titull ekzekutiv pasi nuk ka marrë formë të prerë, ndërsa kundër tij është depozituar ankim brenda afatit ligjor.

7. Krahës kërkesëpadi së mësipërme, në datën 5.9.2014, përmes shërbimit postar, MZHETS-ja ka dërguar në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ankimin kundër vendimit nr. 601, datë 12.5.2014, sipas aktit nr. 2624/3 prot., datë 26.5.2014, që më herët ishte dërguar në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë rast ankimi është shoqëruar me fotokopjen e njësuar me origjinalin të një prej faqeve të librit të dorëzimit të postës. Në këtë të fundit, në shënimet e datës 26.5.2014, pasqyrohet dërgimi i dy shkresave, ndër to edhe ajo nr. 2624/3, në adresë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Mbi shënimet e kësaj date është edhe vula postare që mban datën 26.5.2014. Ankimi është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës në datën 8.9.2014.

8. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, gjyqtari i vetëm i saj, ka verifikuar plotësimin e kushteve të pranueshmërisë për shqyrtim të ankimit të MZHETS-së kundër vendimit nr. 601, datë 12.5.2014 dhe me vendimin e datës 8.9.2014 ka vendosur pranimin e ankimit duke urdhëruar njoftimin e tij kërkuësës. Për sa i përket afatit të paraqitjes së ankimit,

gjyqtari i vetëm në vendimin e tij ka evidentuar se ai është nisur me postë në datën 26.5.2014 në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pas njoftimit të ankimit kërkesja ka paraqitur kërkesë për kthimin e ankimit bazuar në nenin 450 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), me pretendimin se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor 15-ditor. Po ashtu kërkesja ka paraqitur edhe kundërankim, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. 601, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

9. Mbi ankimin e MZHETS-së dhe kundërankimin e kërkeses, çështja e themelit është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit, ndërkohë që pas njoftimit të bërë për shqyrtimin e çështjes, kërkesja ka paraqitur një parashtrësë me shkrim, duke kërkuar mospranimin e ankimit të MZHETS-së, për shkak të depozitimit të tij jashtë afatit ligjor. Respektimi i afatit të paraqitjes së ankimit dhe pranueshmëria për shqyrtim e tij është bërë objekt shqyrtimi nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka arritur në përfundimin se ankimi është paraqitur konform kërkesave ligjore të neneve 44, 45 dhe 46 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), brenda afatit ligjor, në respektim të formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga neni 454 i KPC-së, përpara gjykatës kompetente, nga subjekti i legjitimuar pasivisht në padi, i legjitimuar edhe në të drejtën e ankimit, jashtë kushteve ndaluese të nenit 45 të ligjit nr. 49/2012. Pretendimi i kërkeses është gjetur i pabazuar nga ajo gjykatë, ndërsa ka pranuar se ankimi i MZHETS-së, për shkaqe që nuk dihen, është depozituar gabimisht nga shërbimi postar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është përcjellë për veprime ligjore drejt Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës me shkresën nr. 10720 prot., datë 4.9.2014 të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Po sipas kësaj gjykate, me të drejtë gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së parë, për veprime të shërbimit postar dhe sekretarisë gjyqësore që nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi MZHETS-në, ka vendosur pranimin e ankimit, duke e konsideruar të paraqitur brenda afatit ligjor (*shih vendimin nr. 880, datë 23.4.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, faqja 16, pika 8*). Në përfundim të gjykimit, pas shqyrtimit të çështjes në themel, me vendimin nr. 880, datë 23.4.2015, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke rrëzuar kërkesëpadinë e kërkeses.

10. Kërkesja ka ushtruar rekurs, për të cilin Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, ka vendosur mospranimin e tij, duke vlerësuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012, të cilat do ta bënë të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas saj, përfundimi i arritur nga gjykata e apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, ndërsa pretendimet e ngritura në rekurs që ngrenë çështje të vlerësimit të provave dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih vendimin nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 5*).

11. Në datën 1.9.2022 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesë sipas objektit. Në datën 1.12.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë të dokumenteve.

12. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 503, datë 13.9.2017, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, të shfuqizuar më vonë me vendimin nr. 110, datë 2.3.2022 të tij, i ka kaluar MFE-së kompetencat e MZHETS-së. Për këtë shkak, në tekstin e këtij vendimi, emrat e këtyre institucioneve janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

13. Kërkesja, në mënyrë të përmblodhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

13.1. E drejta për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

13.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar ankimin e MZHETS-së të paraqitur tej afatit ligjor 15-ditor. Gjykata nuk ka hetuar për faktin e ekzistencës së dy shënimeve për datën e depozitimit të ankimit, mosekzistencën e zarfit postar të dërgimit të tij, ekzistencën e dy numrave të ndryshëm protokollit në kopjen e ankimit dhe në librin e protokollit, si dhe për datën 28.5.2014 që mban vula në kopjen e ankimit. Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ka marrë formë të prerë dhe kërkesja ka nisur procedurat për ekzekutimin e tij. Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në shkelje të parimit të sigurisë juridike, ka vendosur mospranimin e rekursit, pavarësisht se ai përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

13.1.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi çështja është gjykuar nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit. Me qëllim zhvillimin e debatit dhe vlerësimin e konstatimit në mënyrë të plotë dhe të saktë për datën e paraqitjes së ankimit, Gjykata Administrative e Apelit duhej ta shqyrtonte çështjen në seancë gjyqësore me prani të palëve, çka nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

13.1.3. *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, në drejtim edhe të *së drejtës së mbrojtjes*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka trajtuar në vendim çështjet ligjore procedurale civile dhe administrative të paraqitura nga kërkesja në datën 15.4.2015. Ajo nuk ka bërë analizë të kundërshtimeve të paraqitura prej saj, nuk ka administruar në gjykim dokumentacionin e provat e nevojshme për sqarimin e afatit të depozitimit të ankimit, si dhe nuk ia ka nënshtruar ato debatit gjyqësor. Kjo nuk është riparuar as nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

13.1.4. *Parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur*, si rrjedhojë e veprimeve të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e cila në datën e depozitimit të ankimit ka qenë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Shënimet për paraqitjen e ankimit të ministrisë brenda afatit janë vendosur qëllimisht prej saj në dosjen gjyqësore të themelit, çka ka cenuar pavarësinë e pushtetit gjyqësor, në shkelje të neneve 7 dhe 135, pika 1, të Kushtetutës. Zarfi i datës 5.9.2014, i vendosur në dosje i përket gjykimit tjetër të iniciuar nga ministria për pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

13.1.5. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk ka trajtuar në vendim çështjet ligjore të paraqitura nga kërkesja, ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur në mënyrë standarde, pa një analizë juridiko-ligjore të çështjes, pa bërë interpretim ligjor të konfliktit në raport me faktet, provat dhe ligjin e zbatueshëm, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve të saj, që kishin të bënin me zbatimin e gabuar të ligjit procedural.

13.2. *Parimi i barazisë përpara ligjit*, pasi pretendimet e saj të datës 15.4.2015 janë vlerësuar përciptazi nga Gjykata Administrative e Apelit, duke favorizuar palën e paditur, përmes shqyrtimit të ankimit të saj të paraqitur jashtë afatit ligjor. I njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka favorizuar MZHETS-në, duke mbajtur standard të dyfishtë mes subjekteve private dhe institucioneve publike. Kërkesja është vendosur në kushte pabarazie edhe në raport me shtetas të tjerë, të cilëve u është pranuar rekursi kur ankimi i institucionit është paraqitur jashtë afatit, duke u vendosur kthimi i çështjes për rigjykim në apel.

13.3. *E drejta e pronës*, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke i mohuar të drejtën për përfitimin e vlerave financiare të pagës, si rrjedhojë e largimit të padrejtë nga detyra, çka ndikon në shumën e përfituar nga sigurimet shoqërore pas mbushjes së moshës së pensionit të pleqërisë.

14. Subjekti i interesuar, MFE-ja, i përfaqësuar nga Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se:

14.1. Pretendimi i kërkeses për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar. Ajo nuk ka paraqitur argumente të qarta dhe të lidhura në mënyrë direkte me pretendimin për shqyrtimin e ankimit të paraqitur tej afatit ligjor. Argumentet e parashtruara prej saj i përkasin juridiksionit të gjykatave më të ulëta dhe jo atij kushtetues. Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për gjë të gjykuar, por për një proces gjyqësor të shqyrtuar në të tria shkallët e gjykimit. Ndërkohë që është e vërtetë

se në dosjen gjyqësore është paraqitur vendimi i formës së prerë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, por kundër këtij vendimi është bërë ankim brenda afatit ligjor nga MFE-ja, i cili është depozituar gabimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çka është arsyetuar edhe nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka vendosur pranimin e ankimit. Ky fakt është analizuar e arsyetuar më tej edhe në vendimin e gjykatës së apelit.

14.2. Pretendimi i kërkuësës për *cenimin e së drejtës së aksesit* është haptazi i pabazuar. Gjykimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë përcaktohet shprehimisht në nenin 61 të ligjit nr. 49/2012.

14.3. Pretendimet e kërkuësës për *cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit* janë përsëritje e pretendimeve të tjera të parashtruara për vendimmarrjet e gjykatës së apelit dhe të Gjykatës së Lartë. Sekretaria e Gjykatës së Lartë ka kryer njoftimin për gjykimin e çështjes në dhomën e këshillimit në përputhje me ligjin, përmes shpalljes publike. Vendimmarrja e gjykatave bazohet në legjislacionin konkret, provat e ndodhura në dosje e në bindjen e tyre të brendshme dhe jo në pretendimet e parashtruara nga palët.

14.4. Gjykatat kanë respektuar *standardin e arsyetimit të vendimit*, duke i dhënë përgjigje të argumentuar kërkuësës për kushtet e pranueshmërisë dhe ligjshmërinë e ankimit të ministrisë.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

15. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

16. Si bartëse e të drejtave kushtetuese kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Një kriter tjetër që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuësi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike efektive të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në thelb (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin konkret, kërkuësja ka kundërshtuar në Gjykatë vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Gjykatës së Lartë që kanë vendosur për çështjen e largimit të saj nga puna. Vendimi i Gjykatës së Lartë ka përmbyllur procesin gjyqësor administrativ në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm. Pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual kërkuësja i ka ngritur, në thelb, në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke shteruar mjetet

juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, përpara se t’i drejtohet Gjykatës.

19. Në lidhje me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.5.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 1.9.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

20. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkesja ka pretenduar se gjykatat kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, së drejtës së aksesit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, standardit të arsytimit të vendimit, si dhe parimin e barazisë përpara ligjit e të drejtën e pronës.

21. Kështu, sipas kërkeses, gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë cenuar të drejtën e aksesit për shkak të gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Gjykata vëren se nenet 49 dhe 61 të ligjit nr. 49/2012 kanë përcaktuar shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë, si rregull, në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve dhe në seancë gjyqësore me prani të palëve në rastet e parashikuara nga nenet 51, pika 1 dhe 62, pika 1, të po këtij ligji. Duke pasur parasysh parashikimet ligjore konkrete dhe faktin që pretendimet e parashtruara nga kërkesja në gjykimin në apel dhe në Gjykatën e Lartë janë marrë parasysh nga këto gjykata, Gjykata vlerëson se kërkesja nuk ka arritur të përcaktojë cenimin e së drejtës së aksesit si rrjedhojë e gjykimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Nga ana tjetër, ashtu siç Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj, procesi gjyqësor konsiderohet i rregullt, për sa kohë që në një shkallë gjykimi është zhvilluar në seancë gjyqësore publike, gjatë së cilës kërkeses i është dhënë mundësia për t’u dëgjuar dhe mbrojtur (*shih vendimin nr. 28, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Po kështu, Gjykata vëren se pretendimet e kërkeses për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur ngrihen ndaj veprimeve të kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, roli i së cilës është administrativ. Për më tepër, gjyqtari i vetëm ka shqyrtuar kushtet formale të pranimit të ankimit të ministrisë, përfshirë edhe veprimet administrative të kancelares e të sekretarisë gjyqësore, duke mbajtur qëndrim konkret për pranimin e ankimit, ndaj, në rastin konkret, nuk vërehet se si veprimet e kancelares të kenë cenuar pavarësinë e gjykatës. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkeses për cenimin e këtij parimi nuk janë ngritur në nivel kushtetues.

23. Në vijim, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi i kërkeses për cenimin e parimit të barazisë para ligjit, si rrjedhojë e shqyrtimit të ankimit të ministrisë të paraqitur jashtë afatit ligjor, nuk është ngritur në nivel kushtetues.

24. Për sa u përket pretendimeve të tjera të kërkeses për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike, parimit të barazisë së armëve e kontradiktoritetit dhe standardit të arsytimit të vendimit, si dhe për cenimin e së drejtës së pronës, duke mbajtur në konsideratë thelbin e tyre, Gjykata vlerëson t’i analizojë ato në vijim, në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike, si aspekt i së drejtës për proces të rregullt ligjor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike

25. Kërkesja ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar ankimin e MZHETS-së, pavarësisht paraqitjes së tij tej afatit ligjor 15-ditor, edhe pse ka evidentuar mungesën e zarfit përmes të cilit pretendohet se ai është depozituar gabimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke mos marrë parasysh shkresën e kancelares së asaj gjykate, sipas së cilës rezultonte se ankimi ishte depozituar jashtë afatit. Po kështu, gjykata nuk ka hetuar faktin e ekzistencës së dy shënimeve për datën e depozitimit të ankimit, mosekzistencën e zarfit postar të dërgimit të tij, ekzistencën e dy numrave të ndryshëm protokollit në kopjen e ankimit dhe në librin e protokollit, si dhe për datën 28.5.2014 që mban vula në kopjen e ankimit.

Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës ka marrë formë të prerë dhe kërkesja ka nisur procedurat për ekzekutimin e tij. Nga ana tjetër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në shkelje të parimit të sigurisë juridike, ka vendosur mospranimin e rekursit, pavarësisht se ai përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh dhe nuk ka trajtuar në vendim çështjet ligjore të parashtruara prej saj, nuk ka administruar dokumentacionin ose provat e nevojshme për sqarimin e afatit të depozitimit të ankimit, nuk ia ka nënshtruar ato debatit gjyqësor, si dhe nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të saj, çka nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

26. Subjekti i interesuar, MFE-ja, ka prapësuar se kërkesja nuk ka paraqitur argumente të qarta dhe të lidhura në mënyrë direkte me pretendimin për shqyrtimin e ankimit të paraqitur tej afatit ligjor. Argumentet parashtruara prej saj i përkasin juridiksionit të gjykatave më të ulëta dhe jo atij kushtetues. Në rastin konkret nuk bëhet fjalë për gjë të gjykuar, por për një proces gjyqësor të shqyrtuar në të tria shkallët e gjykimit. Ndërkohë që është e vërtetë se në dosjen gjyqësore është paraqitur vendimi i formës së prerë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, kundër këtij vendimi është bërë ankim brenda afatit ligjor nga MFE-ja, i depozituar gabimisht në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, çka është arsyetuar edhe nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka vendosur pranimin e ankimit. Ky fakt është analizuar e arsyetuar më tej edhe në vendimin e gjykatës së apelit. Gjykatat kanë dhënë përgjigje të argumentuar për kushtet e pranueshmërisë dhe ligjshmërinë e ankimit të ministrisë.

27. Për sa i përket procesit të rregullt ligjor, siguria juridike është parë nga Gjykata në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, e cila nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 10, datë 7.3.2023; nr. 11, datë 16.4.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në funksion të parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka pranuar se mbrojtja kushtetuese dhe ligjore e të drejtave dhe lirive të individit mund të realizohet vetëm kur ushtrohet brenda afateve ligjore të përcaktuara. Përcaktimi i këtyre afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Mospërcaktimi i këtyre afateve do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment, një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 29, datë 15.5.2014; nr. 5, datë 2.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendosja e afateve ligjore kohore synon garantimin e parimit të sigurisë juridike, miradministrimin e drejtësisë, realizimin e një procesi të rregullt ligjor, dhënien e drejtësisë në kohën e duhur, si dhe shmangien e abuzimit me të drejtat (*shih vendimet nr. 9, datë 7.2.2017; nr. 26, datë 15.12.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata vëren se neni 44 i ligjit nr. 49/2012, në fuqi në kohën e paraqitjes së ankimit dhe aktualisht, referon në KPC në lidhje me afatet e ankimit. Kështu, sipas neneve 148 dhe 149 të po këtij kodi, kur afati është caktuar me ditë dhe me orë, përjashtohet dita dhe ora në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati dhe ai nuk quhet i humbur kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

30. Duke iu rikthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata eidenton se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së kërkuases, rikthimin e saj në pozicionin e punës, detyrimin e MZHETS-së t'i paguajë pagën dhe përfitimet e tjera nga momenti i shkëputjes së marrëdhënieve financiare deri në momentin e rikthimit në detyrë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të objektit. Në kushtet kur nuk ka rezultuar ankim i paraqitur ndaj këtij vendimi nga palët, kërkesja është pajisur nga kancelarja e gjykatës me kopje të tij me shënimin "Vendimi mori formë të prerë", duke vijuar edhe me procedurat për vënien e tij në ekzekutim.

31. Nga dosja gjyqësore e tërhequr për qëllime të gjykimit kushtetues të çështjes, Gjykata konstaton se në datën 26.5.2014, MZHETS-ja ka ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e dorëzuar atë në postë. Ky ankim, ndërkohë që duhej t'i dërgohej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, i është dërguar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, më pas, në datën 4.9.2014, ia ka përcjellë për veprime Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Për shkak të veprimeve përmbarimore, pasi ka ardhur në dijeni të faktit se ankimi nuk ka mbërritur në kohën e dërgimit të tij në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, MZHETS-ja ka dërguar përsëri me postë ankimin pranë kësaj të fundit, shoqëruar me dokumente shkresore në funksion të vërtetimit të datës së dërgimit të tij në postë. Afati i paraqitjes së ankimit është verifikuar nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke arritur në përfundimin se ankimi është paraqitur në afat, referuar datës së dërgimit në postë, më 26.5.2014. Ankimi i është njoftuar menjëherë kërkuases, e cila ka paraqitur kërkesë për mospranimin e tij, për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor 15-ditor, si dhe kundërankim (*shih dosjen gjyqësore nr. 601, datë 12.5.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, faqet 35–39 dhe 42–50*). Gjykata Administrative e Apelit ka shqyrtuar ankimin e MZHETS-së, ku në konsideratë të kërkesës së kërkuases për mospranimin e tij, ka arritur në përfundimin se kërkesa e saj është e pabazuar, duke vlerësuar se ankimi i MZHETS-së është paraqitur në afat, sikurse me të drejtë ka pranuar edhe gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së parë. Pas shqyrtimit të çështjes në themel për ankimin e MZHETS-së dhe kundërankimin e kërkuases, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuases. Për rekursin e kërkuases, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij, duke arsyetuar se vendimi i gjykatës së apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të kërkesave të ligjit procedural, ndërsa pretendimet e ngritura në rekurs, që ngrenë çështje të vlerësimit të provave, dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj.

32. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtruara nga palët në çështjen konkrete, Gjykata sjell në vëmendje jurisprudencën e saj, sipas së cilës kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh, që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor dhe marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky kontroll është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2021; nr. 9, datë 26.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në këtë kuptim, përcaktimi nëse në rastin e kërkuases MZHETS-ja ka respektuar ose jo afatet ligjore për paraqitjen e ankimit përfshihet në juridiksionin e gjykatave të zakonshme, ndërsa roli i Gjykatës është të përcaktojë nëse interpretimi i bërë nga këto gjykata është në përputhje me Kushtetutën, si dhe nëse kërkuases i është dhënë mundësi efektive për kundërshtimin e vendimit të gjyqtarit të vetëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, që ka pranuar ankimin e ministrisë. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata konstaton se verifikimi nëse ankimi i MZHETS-së është paraqitur brenda afatit ligjor është bërë fillimisht nga gjyqtari i vetëm i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, i cili e ka vlerësuar atë si të paraqitur në afat. Në vijim, përmbushja e këtij detyrimi ligjor është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila ka vlerësuar se trajtimi i këtij fakti bie brenda juridiksionit të saj. Në këto kushte, për qëllime të gjykimit administrativ, gjykata ka administruar provat e nevojshme për përcaktimin e datës së saktë të depozitimit të ankimit nga ministria. Në analizë të këtyre provave, të pretendimeve të palëve, si dhe bazuar në legjislacionin procedural në fuqi, gjykata e apelit ka vlerësuar se ankimi është depozituar në afat, duke e gjetur të drejtë vlerësimin e bërë nga gjyqtari i vetëm. Interpretimi i dispozitave ligjore për afatin e paraqitjes së ankimit i

bërë nga gjykata e apelit është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila e ka vlerësuar atë në respektim dhe zbatim të drejtë të kërkesave të ligjit procedural.

34. Në këndvështrim të sa më sipër dhe në analizë të fakteve kushtetuese në rastin konkret, Gjykata eidenton se kërkuases i është dhënë mundësia të parashtrojë në gjykatat e zakonshme pretendimet e saj për paraqitjen e ankimit të MZHETS-së jashtë afatit. Brenda kompetencave të tyre, gjykatat kanë përcaktuar datën e depozitimit të ankimit dhe në interpretim e zbatim të legjislacionit në fuqi kanë dhënë përgjigje të arsyetuar për vendimmarrjet e tyre. Ndonëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar në mënyrë të përgjithshme për pretendimet e kërkuases për cenimin e parimit të sigurisë juridike, Gjykata vëren se ajo ka marrë përgjigje për to edhe nga kjo gjykatë *(shih vendimin nr. 00-2022-1130, datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, faqja 6, pikat 13 dhe 14).*

35. Për sa më lart, Gjykata vëren se gjykatat kanë vënë në balancë pretendimet e kërkuases në lidhje me parimin e sigurisë juridike përkundrejt së drejtës së aksesit në gjykatë të palës së paditur. Interpretimi që gjykatat u kanë bërë fakteve të çështjes lidhur me datën e depozitimit të ankimit nga pala e paditur, nuk rezulton të jetë arbitrar në kuptimin kushtetues, dhe në këtë mënyrë as të ketë cenuar të drejtat kushtetuese të kërkuases. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se gjykatat e zakonshme kanë vepruar në respektim të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe pretendimi i kërkuases për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar.

36. Në përfundim, Gjykata çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuases, sipas arsytimit të mësipërm, është i pabazuar, ndaj duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.5.2023.

Shpallur më 19.6.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Marjana Semini, Genti Ibrahim